



13-09-2021

Prishtinë / Priština

Nr./Br. 2277-2021

Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 64.2 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe Rregullën Zgjedhore Nr.04/2013 Votimi i Personave me Nevoja dhe Rrethana të Veçanta, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 13.09.2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Miratimin e Rekomandimit për Ndarjen dhe Paketimin e Fletëvotimeve për Votuesit në Institucione – Kategoria e Dytë e VPNV-ve

- I. Miratohet Rekomandimi i Këshillit të Operacioneve Zgjedhore për ndarjen dhe paketimin e fletëvotimeve për votuesit në institucione – kategoria e dytë e VPNV-ve.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Rekomandimi si në pikën I është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 13.09.2021

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi





Data	10.09.2021	Ref. Nr.
Për	Këshillin e Operacioneve Zgjedhore	
Nga	Besnik Buzhala, U.D. i Zëvendësit të Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së Haki Krasniqi, Drejtor i Departamentit për Operacione Zgjedhore	
Përmes	Burim Ahmetaj, Kryeshef Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së	
Lënda	Rekomandim për ndarjen dhe paketimin e fletëvotimeve për votuesit në institucione – Kategoria e Dytë e VPNV-ve	

Bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregullën Zgjedhore Nr. 04/ 2013 Votimi i Personave me Nevoja dhe Rrethana të Veçanta, kategoria e dytë e votuesve përbën votuesit në institucione, që konsiderohen të gjithë votuesit me të drejtë vote me lëvizje të kufizuar në institucion:

- a) Votuesit në hospitalizim,
- b) Njërëzit e moshuar në shtëpitë e caktuar veçanërisht për të moshurait,
- c) Personat me aftësi të zvogëluar mendore në institucione të kujdesit shëndetësor,
- d) Të burgosurit në burgje, dhe
- e) Të paraburgosurit në qendrat e paraburgimit.

Në zgjedhjet parlamentare, ku Republika e Kosovës konsiderohet një zonë e veçantë zgjedhore, procesi i përgaditjes së pakove me fletëvotime është i lehtë, sepse është vetëm një fletëvotim.

Por, procesi i përgaditjeve të pakove me fletëvotime në Zgjedhjet Lokale për votuesit në institucione (kategoria e dytë e VPNV-ve) është shumë më i komplikuar sepse të gjitha komunat e Republikës së Kosovës konsiderohen zona të vecanta zgjedhore (tridhjetë e tetë zona zgjedhore) dhe procesi i përgaditjeve të pakove me fletëvotime bëhet në ambientet e depos së KQZ-së ku mbahen fletëvotimet dhe para ditës së zgjedhjeve stafi i shërbimit të votuesve duhet të bëjë tërheqjen e numrit të caktuar të fletëvotimeve në raport me numrin e regjistruar të votuesve në institucione sipas komunave ku këta votues janë në listën e votuesve.

Tërheqja e fletëvotimeve bëhet nga amat e fletëvotimeve rezervë, dhe për të cilat duhet të mbahet evidencë për numrin e shkëputur të fletëvotimeve.

Për shembull:

- a) Në qendrën korrektuese në Dubravë, mund të kemi votues të regjistruar nga të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, të cilët në ditën e zgjedhjeve janë në vuatje të dënimit dhe për të cilët duhet të që fletëvotimet të shkëputen nga amat e fletëvotimeve për të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Në Zgjedhjet Lokale të vitit 2017 votues të regjistruar në këtë institucion kemi pasur nga 17 komuna të Republikës së Kosovës.
- b) Kështu ndodh edhe në institucionet e kujdesit shëndetësorë, në institucionet tjera korrektuese dhe në qendra të paraburgimit.

Pra, i gjithë ky proces në zgjedhjet lokale kërkon angazhim të madh dhe të saktë në shkëputjen e fletëvotimeve nga amat e fletëvotimeve rezervë dhe evidentimin e numrit të fletëvotimeve që shkëputen dhe gjithashtu, në evidentimin e numrave serik.

Andaj, lidhur me këtë,

REKOMANDOJMË:

1. Fletëvotimet për Kuvendet Komunale dhe për Kryetar Komune të shtyen dhe paketohen ndaras nga operatori ekonomik, për kategorinë e dytë të VPNV-ve "Votuesit në institucione".
2. Shtypja dhe paketimi i këtyre fletëvotimeve të bëhet në mënyrë të vëçantë nga shtypja dhe paketimi i fletëvotimeve të rregullta dhe fletëvotimeve rezervë. Fletëvotimet e shtypura për këtë kategori të votuesve do të paketohen në pjesën e sipërme të paketimit në kuadër të çdo komune që përmban fletëvotimet e shtypura si të rregullta dhe fletëvotimet rezervë.
3. Fletëvotimet për asamble komunale dhe për kryetar komunë do ta kenë kodin si në vijim: **VPNV/ OGPP – 02** (shkurtesa VPNV/ OGPP nënkupton *Votimin e Personave me Nevoja të Veçanta*, ndërsa numri 02 nënkupton kategorinë e dytë të votuesve me nevoja të veçanta "Votuesit në institucione").
4. Sekretariati i KQZ-së obligohet që të bëjë llogaritjen e numrit të fletëvotimeve për kuvende komunale dhe kryetar komunash, duke u bazuar në numrin e votuesve në institucione të regjistruar në Zgjedhjet Lokale të vitit 2017.
5. Numri i fletëvotimeve për kuvende komunale dhe kryetar të komunave që do të shtypen, do të zbritet nga numri i planifikuar për shtypjen e fletëvotimeve rezervë për Kuvende Komunale dhe për Kryetar të Komunave.